Neni 287 Produktet e vepres penale ose veprimtarisë kriminale	2									
Neni 287/a Llogari anonime										
Neni 287/b Pervetesimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale										
Totali	2									

VEPRA PENALE KUNDËR SEKRETIT DHE KUFIJVE SHETËTËRORE	2016					2017				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenuar
Neni 294 Tregtimi i sekretit shtetëror nga personi që i është besuar										
Neni 295 Tregtimi i sekretit shtetëror nga shtetasit										
Neni 295/a Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete										
Neni 296 Humbja e dokumenteve sekrete										
Neni 297 Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror	71	40	58	40	40	104	42	42	42	42
Neni 298 / 1 / 2 Ndhima për kalim të paligjshëm të kufirit	8		9			2				
Neni 299 Shkelja e rregullave mbi fluturimet										
Totali	79	40	67	40	40	106	42	42	42	42

VEPRA PENALE KUNDËR DREJTËSISË	2016					2017				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denu ar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denua r
Neni 300 Moskallzimi i krimimit			2	2	2					
Neni 301 Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës	2	1	1	1						
Neni 302 Përkrahja e autorit të krimimit										
Neni 303 Fshehja ose asgjësimi i kufomës										
Neni 304 Detyrimi për të kallzuar provën										
Neni 305 Kallzimi i rremë	1	1	1	1	1					
Neni 305/a Deklaratat e rreme përpara prokurorit										
Neni 305/b Deklaratat e rreme përpara of.pol.gjyq.										
Neni 306 Dëshmia e rreme	4	3	5	5	2					
Neni 307 Refuzimi për të dëshmuar										
Neni 308 Përkthimi i rremë										
Neni 309 Ekspertimi i rremë										
Neni 310 Mosparaqitja e dëshmitarit, ekspertit apo përkthyesit										
Neni 311 Kanosja për të mos kallëzuar										
Neni 312/a Kanosja për deklarime a dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë										
Neni 313 Fillimi i paligjshëm i ndjekjes penale										
Neni 313/a Zhdukja ose humbja e fashikullit										
Neni 313/b Ndalimi i dhënies dhe i shpalljes së të dhënave në kundërshtim me ligjin										
Neni 314 Përdorimi i dhunës gjatë hetimeve										
Neni 316 Kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit										
Neni 317 Kanosja e gjyqtarit										
Neni 318 Fyerja e gjyqtarit	1									
Neni 320 Pengime për ekzekutimin e e vendimeve të gjykatës	3	3	3	3	2					
Neni 320/a Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës										
Neni 321 Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës										
Neni 322 Prishja e vulave dhe shenjave										
Neni 323 Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit										
Neni 324 Dhënia ndihmë një të burgosuri për largim										
Totali	11	8	12	12	7					

VEPRAT PENALE PËR ZGJEDHJET E LIRA	2016					2017				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjkim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjkim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjkim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjkim	Nr. Pand denuar
Neni 325 Pengimi i subjekteve zgjedhjore										
Neni 326 Falsifikimi i dokumenteve dhe rezultateve të zgjedhjeve										
Neni 327 Shkelja e fshehtësisë së votimit										
Neni 327/a Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar										
Neni 328/a Detyrimi për pjesëmarrje në veprimtari politike						5				
Neni 329 Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje										
Neni 330 Pengimi i zgjedhësit										
Neni 330/a Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve										
Neni 331 Shkelja e të drejtës së zgjedhjes										
Neni 332 Shpërdorimi i autoritetit ushtarak										
Totali						5				

VEPRA PENALE KUNDËR KORRUPSIONIT	2016					2017				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjkim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand . Per gjkim	Nr. Pan d den uar	Nr. Proc d Regj	Nr. proce d per gjkim	Nr. i pan d. Regj	Nr. Pand per gjkim	Nr. Pand denua r
Neni 124/a Kërkimi ose marrja e shpërblimeve për procedurat e birësimit										
Neni 164/a Korrupsion aktiv në sektorin privat										
Neni 164/b Korrupsion pasiv në sektorin privat										
Neni 244 Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike										
Neni 244/a Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë										
Neni 245 Korrupsion aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë										
Neni 245/1 Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike										
Neni 259 Korrupsion pasiv i personave me funksione publike										
Neni 259/a Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë										
Neni 260 Korrupsion pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë										
Neni 312 Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit										
Neni 319 Korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë										
Neni 319/a Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare										
Neni 319/b Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj										
Neni 319/c Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja										
Neni 319/ç Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë										
Neni 319/d Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare										
Neni 319/dh Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj										
Neni 319/e Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja										
Neni 328 Dhenia e shpërblimeve dhe e premtimeve										
Totali										

KRIMI KIBERNETIK	2016					2017				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 74/a Shpërndarja kompjuterike e materialeve komp. pro genocitit ose krimeve kunder njerëzimit										
Neni 84/a Kanosja me motive racizmi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik										
Neni 119/a Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik										
Neni 119/b Fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sist. kompj.										
Neni 143/b Mashtrimi kompjuterik										
Neni 186/a Falsifikimi kompjuterik										
Neni 192/b Hyrja e paautorizuar kompjuterik										
Neni 293/a Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterik										
Neni 293/b Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike										
Neni 293/c Ndërhyrja në sistemet kompjuterike										
Neni 293/ç Keqpërdorimi i pajisjeve										
Totali										

TRAFIKIMI	2016					2017				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 110/1 Heqja e paligjshme e lirisë						1				
Neni 128/b Trafikimi i të miturve										
Neni 138/a Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës										
Neni 141/a Trafikimi i mjeteve motorike	7	1	1	1	1	11				
Neni 278/a Trafikimi i armëve dhe i municionit										
Neni 282/a Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive										
Neni 283/a Trafikimi i narkotikëve										
Totali	7	1	1	1	1	12				

PRODHIMI DHE KULTIVIMI I NARKOTIKËVE	2016					2017				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 283 Prodhimi dhe shitja e narkotikëve	8	2	6	6	4	22	9	14	14	9
Neni 284 Kultivimi i bimëve narkotike	24	2	2	2	2	6				
Neni 284/a Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale										
Neni 284/c Prodhimi dhe fabrikimi i lendeve narkotike dhe psikotrope										
Neni 285 Mbajtja, prodhimi dhe transportimi i sustancave kimike						1				
Totali	32	2	8	8	6	29	9	14	14	9

TREGUESIT NË HETIMET PARAPRAKE

Treguesit e përgjithshëm të ndjekjes penale

Në vitin 2017, Prokuroria pranë Gjykatë së Shkallë së Parë Kukës ka mbartur *111 procedime penale*, me 39 persona nën hetim, ndër të cilët 21 të arrestuar.

Gjatë vitit 2017 janë *regjistruar* 580 procedime penale me 141 persona nën hetim, ndër të cilët 72 persona të arrestuar.

Janë bërë kallëzime nga policia e shtetit 460 procedime penale, kallëzime nga shtetasit 1 procedime penale, kallëzime nga nëpunësi publik 54 procedime penale, kanë ardhur me transferim nga Prokuroritë e tjera 62 procedime penale.

Janë rifilluar hetimet për 3 procedime penale të pezulluara në vitet e tjera. Gjatë këtij viti janë rifilluar hetimet për 53 procedime penale të pezulluara në vitet e tjera dhe është vendosur pushimi i tyre për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

Gjatë vitit 2017 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 200 kallëzime penale.

Për vitin 2017 kanë qenë gjithsej në hetim 691 procedime penale me 313 persona nën hetim, ndër të cilët 93 të arrestuar.

Duke bërë një krahasim me vitin e mëparshëm, rezulton se janë regjistruar 59 procedime penale më pak. Siç konstatohet edhe nga treguesit e mësipërm rezulton se ka një rënie të kallëzimeve penale nga nëpunësit publik dhe organet ligjzbatuese të tjera në vend.

Mënyra e përfundimit të procedimeve penale gjatë vitit 2017 është si më poshtë:

» **Janë pushuar** gjithsej 148 procedime penale me 82 persona nën hetim, me 14 persona të arrestuar.

- Për mungesë fakti janë pushuar 6 procedime penale, një për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 të K.Penal, një procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 174/1 i K.Penal, një procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 248 të K.Penal me 2 të arrestuar, një procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 237, 238 e 278 të K.Penal me 2 të arrestuar, një procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 83 të K.Penal me 1 të arrestuar, një procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 186 e 291 të K.Penal me 1 të arrestuar dhe një procedim penal tjetër për veprën penale të parashikuar nga neni 121/a/1 i K.Penal. Për mungesë të ankimit të të dëmtuarit janë pushuar dy procedime penale për veprat penale të parashikuara nga nenet 88 dhe 88/a K.Penal.
- Për shkaqe të tjera janë pushuar 142 procedime penale.

Peshën më të madhe të këtyre procedimeve penale të pushuara e zënë veprat penale të kalimit të paligjshëm të kufirit, shpërdorimit të detyrës, dhe falsifikimit të dokumentave.

Gjatë hetimit të këtyre çështjeve ka rezultuar se për veprën penale të kalimit të paligjshëm të kufirit janë pushuar 34 procedime penale për shkak të ligjit të amnisisë. Kallëzimet e bëra nga qytetarët e ndryshëm ndaj kompanisë celulare Vodafone Albania janë pushuar 14 procedime penale për shkak të parashkrimit të afatit. Për veprën penale të shpërdorimit të detyrës gjatë vitit 2017 janë pushuar 15 procedime penale.

Është pushuar 1 procedim penal me 1 person të arrestuar për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i K.Penal, me masë sigurimi arrest në burg me afat 1 muaj, ku pas kryerjes së aktit të ekspertimit mjekoligjorë për të dëmtuarin kanë rezultuar dëmtime të lehta dhe i dëmtuari e ka tërhequr ankimin pas normalizimit të marrëdhënieve me personin nën hetim.

» **Janë pezulluar** 86 procedime penale për mosnjohje të autorit të veprës penale.

Peshën më të madhe të këtyre procedimeve penale vazhdojnë ta zënë vepra penale e vjedhjes (47 procedime penale), trafikimi i mjeteve motorrike (6 procedime penale), falsifikimi i dokumentave (6 procedime penale), si dhe vepra penale e kultivimit të bimëve narkotike (4 procedime penale). Një vështirësi në hetimin e këtyre procedimeve penale ka qenë mbledhja e të dhënave dhe marrja e informacioneve qoftë edhe operative nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore për autorët e mundshëm të këtyre veprave penale. Kjo ka ndodhur edhe tek ato ngjarje ku janë fiksuar dhe marrë gjurmë papilare të vlefshme për krahasim me persona të dyshuar për veprën penale të vjedhjes. Po ashtu tek vepra penale e dytë ka patur problematikë në vonesat në kthimin e përgjigjeve të letërporosive.

» **Janë transferuar** 35 procedime penale me 42 persona nën hetim ndër ta, 7 persona të arrestuar.

Shumica e procedimeve penale të transferuara janë për shkak të kompetencës tokësore me çështjet me të mitur, kryesisht për veprat penale të vjedhjes dhe drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt, që i kanë kaluar për hetim Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, Seksionit për të Mitur.

» **Janë dërguar për gjykim** 272 procedime penale me 303 të pandehur, ndër të cilët 58 me masën e sigurimit arrest në burg.

Peshën më të madhe të çështjeve të dërguara për gjykim e zënë për veprën penale të “*Mashtrimit në sigurime*” (67 çështje penale), me 67 të pandehur. Më pas renditen për veprën penale të “*Drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt*” me 24 çështje penale, me 24 të pandehur dhe 4 të arrestuar.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/1,2 janë (15 çështje penale) me 15 të pandehur dhe për veprën penale të “*Dhunës në familje*” kemi 8 çështje me 8 të pandehur me 6 të arrestuar.

Për vitin 2017 janë përfunduar gjithsej 541 procedime penale.

Kanë mbetur në hetim për vitin vazhdues 150 procedime penale me 56 persona nën hetim me 6 persona të arrestuar.

Gjatë vitit 2017 nga ana e Prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës është ushtruar apelim ndaj vendimeve të Gjykatës në 19 raste, dhe apelim ndaj masave të sigurimit personal të dhënë nga Gjykata në 5 raste.

Më poshtë po i pasqyrojmë më hollësisht treguesit e ndjekjes penale

VEPRAT PENALE KUNDËR PERSONIT

Nga viti 2016 janë mbartur 3 procedime penale me 3 të pandehur, nga të cilët 2 të arrestuar.

Janë regjistruar për vitin 2017 gjithsej 55 procedime penale me 20 të pandehur, ndër të cilët 15 me masë sigurimi arrest në burg. Gjatë këtij viti është regjistruar 1 procedim penal me 2 persona të arrestuar për veprën penale të parashikuar nga neni 76-22 të K.Penal, 1 procedim penal me 1 person të arrestuar për veprën penale të parashikuar nga neni 83/a të K.Penal, 1 procedim penal me 1 person të arrestuar për veprën penale të parashikuar nga neni 88 të K.Penal dhe 1 procedim penal me 1 person të arrestuar për veprën penale të parashikuar nga neni 88/a të K.Penal.

Për këto vepra penale, gjatë vitit 2017 janë hetuar gjithsej 58 procedime penale me 23 të pandehur.

Janë pushuar 15 procedime penale, për shkaqe të tjera, për veprat penale të parashikuara nga nenet 83/a, 88, 88/a, 89, 99, 112/1, 121/a/1, 124/1 dhe 130/a/1 të K.Penal. Janë pushuar hetimet për 1 të pandehur të arrestuar për veprën penale të parashikuar nga neni 83/a të K.Penal, 88 i K.Penal, për shkak se nga akti i ekspertimit mjekoligjorë kanë rezultuar dëmtime të lehta duke u kualifikuar vepra penale më pas plagosje e lehtë me dashje dhe i dëmtuari e ka tërhequr ankimin për këtë veprë penale.

Është pezulluar hetimi për mosnjohje të autorit për këto grup veprash penale : për 1 procedim penal për veprën penale parashikuar nga neni 84 të K.Penal e 1 procedim penal për veprën penale parashikuar 124/1 të K.Penal.

Janë transferuar për shkak të kompetencës tokësore dhe lëndore 2 procedime penale me 2 persona nën hetim.

Janë dërguar për gjykim 22 procedime penale me 23 të pandehur, ku 12 kanë qenë me masën e sigurimit arrest në burg.

Vlen të përmendim këtu, ndër të tjera, 2 procedime penale janë për veprën penale të “*Vrasjes me dashje*”, mbetur në tentativë, me 4 të pandehur të arrestuar, 1 të pandehur të arrestuar për veprën penale të “*Plagosje e rëndë me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së*

nevojshme” dhe 9 procedime penale me 9 të pandehur, ndër ta, 7 të arrestuar, për veprën penale të “Dhunës në familje”.

Gjithsej për këto grup veprash penale, për vitin 2017 janë përfunduar 12 procedime penale.

Për vitin 2018 *kanë mbetur* në hetim 22 procedime penale me 8 persona nën hetim, ndër të cilët, 1 është me masën e sigurimit arrest në burg.

Parë në këndvështrim me vitin 2016 konstatohet se për këto grup veprash penale ka një rënje të numrit të këtyre veprave penale në përgjithësi, të kimit kundër jetës së personit, të dhunës në familje në veçanti.

VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE EKONOMISË

Janë *mbartur* nga viti i kaluar 48 procedime penale.

Gjatë vitit 2017 janë *regjistruar* 262 procedime penale.

Kanë ardhur me transferim nga Prokuroritë e tjera 13 procedime penale.

Janë *pushuar* për shakqe të tjera 53 procedime penale me 14 persona nën hetim, ku njëri prej tyre ka qenë i arrestuar për veprën penale të parashikuar nga neni 174/1 i K.Penal, kjo për shkaqe të tjera, për shkak se fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale.

Peshën më të madhe të pushimeve të procedimeve e zënë për veprën penale “Flasifikimit të dokumentave” me 14 procedime, “Falsifikimi i vulave, i stamapave ose formularëve” me 7 procedime, të mashtrimit në sigurime (5 procedime penale) e “Shpërdorimi i tokës” me 5 procedime penale. Është pushuar 1 procedim penal për veprën penale të trafikimit të mjeteve motorike dhe 1 procedim penal për veprën penale të mashtrimit, 3 procedime penale janë pushuar për veprën penale të parashikuar nga neni 174/1 të K.Penal etj,

Janë *pezulluar* për mosnjohje të autorit të veprës penale 72 procedime penale.

Peshën më të madhe vazhdon ta zë vepra penale e vjedhjes (47 procedime penale).

Janë transferuar për në Prokuroritë e tjera 6 procedime penale me 9 persona nën hetim.

Nga këto vepra penale, *janë dërguar* për gjykim 133 procedime penale me 139 të pandehur, ndër ta, 17 me masë sigurimi arrest në burg. Vërdin kryesor të procedimeve penale të dërguar për gjykim për këto grup veprash penale e zënë për veprën penale të mashtrimit në sigurime (67 procedime penale), për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm” me 15 procedime penale, “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve” me (11 procedime penale), pastaj renditen për veprat penale në fushën e doganave (5 procedime penale), për veprën penale të “Vjedhjes” (7 procedime penale) e për veprën penale të “Vjedhjes së energjisë elektrike ose impulseve telefonike me (5 procedime penale) etj.

Gjatë këtij viti, për këto grup veprash penale janë përfunduar 255 procedime penale, kanë mbetur në hetim për vitin në vazhdim 60 procedime penale.

Numrin më të madh të procedimeve vazhdojnë ta zënë vepra penale e “*Mashtrimit në sigurime*” dhe ajo e “*Vjedhjes së pasurisë*”, pastaj për veprat penale në fushën e doganave, falsifikimit etj.

Ajo çfarë mund të theksohet karahasuar me vitin e kaluar është se kemi një rritje të numrit të çështjeve të dërguara për gjykim në krahasim me ato të pezulluara dhe të pushuara, por, vazhdojmë të kemi problematikë me hetimin e veprës penale të vjedhjes, ku nga 72 procedime penale të regjistruar për këtë vit, 47 prej tyre janë pezulluar për mosnjohje të autorit të veprës penale, vetëm 7 procedime penale janë dërguar për gjykim. Problematikë në hetimin e kësaj vepre penale ka qenë mungesa e mbledhjes së të dhënave dhe marrja e informacioneve në rrugë të ndryshme nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore për autorët e mundshëm të veprës penale. Kjo, ka ndodhur edhe tek ato ngjarje ku janë fiksuar dhe marrë gjurmë daktiloskopike të vlefshme për t’u krahasuar me persona të dyshuar. Një konsistim i tillë qëndron edhe për procedimet penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitet e kaluara, të pezulluara më parë, të cilët janë pushuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale për këtë vepër penale.

Për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale janë pushuar 34 procedime penale.

VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT

Nga viti 2016 nuk është *mbartur* asnjë procedim penal.

Gjatë vitit 2017 janë *regjistruar* 3 procedime penale me 1 të pandehur në gjendje të lirë për veprën penale të “*Prerjes së paligjshme të pyjeve*”.

Janë *pushuar* 2 procedim penal për shkaqe të tjera dhe 1 procedim është në hetim.

VEPRAT PENALE KUNDËR AUTORITETIT TË SHPETIT

Nga viti 2016 janë mbartur 56 procedime penale.

Gjatë vitit 2016 janë *regjistruar 191 procedime penale*, kanë ardhur me transferim *47 procedime penale*.

Gjithsej ka patur në hetim për këto grup veprash penale *247 procedime penale* me 93 persona nën hetim e 132 të pandehur, nga të cilët 40 persona të arrestuar.

Janë *pushuar* për shkaqe të tjera 76 procedime penale me 55 persona nën hetim, 3 prej tyre të arrestuar (1 i pandehur për veprën penale të parashikuara nga neni 283/1 i K.Penal dhe 2 për veprën penale të parashikuar nga neni 259 të K.Penal).

Janë *pezulluar* për mosnjohje të autorit 9 *procedime penale*. Peshën më të madhe të procedimeve penale të pezulluara e zënë për veprën penale të kultivimit të bimëve

narkotike (4 procedime penale), si dhe 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 278 të K.Penal.

Janë *transferuar 27 procedime penale.*

Janë *dërguar gjyqit 118 procedime penale me 140 të pandehur*, ku 21 prej tyre kanë qenë me masën e sigurimit arrest në burg.

Nga procedimet penale të dërguara për gjykim vlen të përmendim: 5 procedime penale me 18 të pandehur, punonjës të administratës shtetërore, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 të K.Penal, 2 të pandehur janë dërguar për gjykim për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/1 i K.Penal, 42 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 297 të K.Penal, 7 procedime penale me 7 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 242 të K.Penal, 9 procedime penale me 14 të pandehur, nga të cilët 10 të arrestuar për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, 24 procedime penale me 24 të pandehur, nga të cilët 4 të arrestuar për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i K.Penal.

Gjatë vitit 2017 janë përfunduar gjithsej për këto grup veprash penale 230 procedime penale.

Kanë *mbetur në hetim* për vitin në vazhdim 64 procedime penale.

Nga treguesit konstatohet se ka një rënje të veprës penale të prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit, shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, të vetëgjyqësisë, por ka një rritje të veprave penale të drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt, të shpërdorimit të detyrës, të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve dhe kultivimit të bimëve narkotike, kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror, dhënies ndihmë për kalimin e paligjshëm të kufijve.

VEPRAT PENALE KUNDËR DREJTËSISË

Për këto grup veprash penale nuk ka patur të mbartura nga viti 2016.

Edhe për vitin 2017 nuk është *regjistruar asnjë procedim penal.*

VEPRAT PENALE OË PREKIN ZGJEDHJET E LIRA

Edhe për këtë grup veprash penale nuk ka patur të mbartura nga viti 2016.

Për vitin 2017 duke qenë edhe viti ku u mbajtën zgjedhjet e përgjithshme janë regjistruar 5 procedime penale me 2 persona nën hetim. Janë pushuar 4 procedime penale me një persona nën hetim dhe për 1 procedim vazhdojnë hetimet.

TREGUESIT NË GJYKIM

Treguesit e përgjithshëm të çështjeve penale të gjykuara

Për vitin 2018 kanë mbetur në gjykim **94 çështje penale me 110 të pandehur, nga të cilët 26 të arrestuar.**

Gjatë vitit 2017 janë dërguar për **gjykim 272 çështje penale** me 303 të pandehur, 58 me masën e sigurimit arrest në burg.

Gjithsej për vitin 2017 kanë qenë në gjykim 368 çështje penale me 413 të pandehur, ndër ta, 66 me masë sigurimi arrest në burg.

Për vitin **2017 janë gjykuar 293 çështje penale me 322 të pandehur.** Nga këto, janë gjykuar me gjykim të drejtpërdrejtë 2 çështje penale, me gjykim të zakonshëm 17 çështje penale, me gjykim të shkurtuar 264 çështje penale. Është bërë gjykimi në mungesë të të pandehurit për 10 çështje penale.

Për vitin 2018 kanë mbetur në gjykim **96 çështje penale me 110 të pandehur, ndër të cilët 8 të arrestuar.**

Nga prokurorët janë kërkuar këto lloje dhe masa dënimi:

Për 64 të pandehur është kërkuar dënimi me gjobë, për 14 të pandehur dënimi me burgim në minimum, për 36 të pandehur dënim me burgim mesatar, për 1 të pandehur dënimi me burgim në maksimum, për 1 të pandehur është kërkuar burgim i përjetshëm. Për 157 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë, për 30 të pandehur pushim çështje, kjo për veprën penale të parashikuar nga neni 297 i K.Penal, është kërkuar tërheqja e akteve për 2 çështje penale.

Në lidhje me kërkesat e bëra nga prokurorët, Gjykata ka dhënë vendime për lloje dhe masa dënimi si më poshtë:

Për 64 të pandehur është vendosur dënimi me gjobë, për 14 të pandehur dënimi me burgim në minimum, për 35 të pandehur me burgim mesatar, për 1 të pandehur dënimi me burgim në maksimum, për 1 të pandehur është kërkuar burgim i përjetshëm, për 149 të pandehur është vendosur pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim, për 32 të pandehur pushim çështje, për 8 të pandehur është vendosur pafajësi.

Më poshtë po i trajtojmë më hollësisht treguesit e çështjeve penale në gjykim

VEPRAT PENALE KUNDËR PERSONIT

Nga viti 2016 kanë qenë *mbartur* në gjykim 3 çështje penale me 3 të pandehur, nga të cilët 2 të arrestuar.

Gjatë vitit 2017 janë *dërguar për gjykim* 21 çështje penale me 24 të pandehur, nga të cilët 12 persona të arrestuar.

Janë gjykuar gjithsej nga këto grup veprash penale 10 procedime penale me 10 të pandehur.

Për vitin 2017 kanë *mbetur në gjykim* 14 çështje penale me 17 të pandehur.

Në konkluzionet përfundimtare janë kërkuar nga Prokurorët:

Për 1 të pandehur është kërkuar nga ana e Prokurorit dënimi me burgim të përjetshëm për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 79/dh, kërkesë e lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Shkallës së Parë Kukës.

Janë dhënë për 1 të pandehur dënim me gjobë, për 2 të pandehur dënim me burgim në minimum, për 10 të pandehur dënim me burgim mesatar, për 2 të pandehur dënimi me burgim në minimum, për 6 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim, për 1 të pandehur pushim çështje pasi është terhequr ankimi në gjykim nga i demtuari për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i K.Penal.

Gjykata ka vendosur në përputhje me kërkesën e prokurorit.

Dënimi me gjobë është kërkuar për 1 të pandehur, akuzuar për veprën penale të “Kanosjes” Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit është kërkuar për 2 të pandehur të arrestuar për veprën penale të dhunës në familje, në ato rrethana kur ka patur pasoja në shëndetin e të dëmtuarës, në rastet kur pas ngjarjes janë normalizuar marrëdhëniet mes viktimës dhe autorit bashkëjetues.

VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE EKONOMISË

Për vitin 2017 janë dërguar gjithsej në gjykim 133 çështje penale me 135 të pandehur nga të cilët 17 të arrestuar.

Janë gjykuar gjithsej 156 çështje penale me 159 të pandehur.

Për vitin 2018 kanë mbetur në gjykim 38 çështje penale me 41 të pandehur me 6 të arrestuar.

Në konkluzionet përfundimtare nga Prokurorët janë kërkuar këto lloje dhe masa dënimi:

Për 31 të pandehur dënim me gjobë, për 13 të pandehur dënim me burgim mesatar, për 114 të pandehur pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë. ËShë vendosur pushimi i 1 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/1 të K.Penal.

Edhe për këtë grup veprash penale Gjykata e Shkallës së Parë Kukës ka vendosur në përputhje me këkesaën e Prokurorit.

VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT

Nga viti 2016 nuk ka patur çështje të mbartur në gjykim për këto grup veprash penale.

Gjatë vitit 2017 janë regjistruar 4 procedime penale nga të cilat 3 procedime penale janë pezulluar për mos zbulim autori dhe 1 çështje penale vazhdon të jetë në hetim.

VEPRAT PENALE KUNDËR AUTORITETIT TË SHTETIT

Nga viti 2016 kanë qenë të mbartura në gjykim 26 çështje penale me 37 të pandehur.

Gjatë vitit 2017 janë dërguar për gjykim për këto grup veprash penale 118 çështje penale me 140 të pandehur.

Për vitin 2017 kanë qenë gjithësej në gjykim 144 çështje penale me 177 të pandehur.

Janë gjykuar gjithësej 102 çështje penale me 126 të pandehur.

Për vitin 2018 kanë mbetur në gjykim për këto grup veprash penale 42 çështje penale me 52 të pandehur.

Në konkluzionet përfundimtare janë kërkuar nga prokurorët këto lloje dhe masa dënimi:

Për 32 të pandehur dënim me gjobë, për 22 të pandehur dënim me burgim në minimum, për 21 të pandehur dënim me burgim mesatar, për 38 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë.

Gjykata ka vendosur për 31 të pandehur dënim me gjobë, për 12 të pandehur dënim me burgim në minimum, për 20 të pandehur dënim me burgim mesatar, për 33 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë.

Për 3 çeshtje është vendosur pushim çeshtje për veprën penale të parashikuar nga neni 248 (6 të pandehur në gjendje të lirë). Për 2 të pandehur është vendosur pafajësi për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal dhe në 3 raste është kërkuar nga ana e Prokurorisë tërheqja e akteve nga Gjykata.

Për rastet kur Gjykata ka vendosur pushimin e çeshtjes dhe pafajësi, nga prokurori i çeshtjes është apeluar vendimi në Gjykatën e Apelit Shkodër, ku akoma nuk ka përfunduar gjykimi i tyre.

Dënimi me gjobë është vendosur për veprën penale të kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror ,për veprën penale të drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt, ku drejtuesi i mjetit ka qenë pa leje drejtimi dhe më pas në respektim të nenit 53/a të K.Penal është vendosur zëvendësimi i dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit.

VEPRAT PENALE KUNDËR DREJTËSISË

Nga viti 2016 nuk është *mbartur* asnjë procedim penal.

Për vitin 2017 duke qenë edhe viti ku u mbajtën Zgjedhjet e Përgjithshme Parlamentare janë regjistruar 5 procedime penale me 2 persona nën hetim. Janë pushuar 4 procedime penale me një persona nën hetim dhe për 1 procedim vazhdojnë hetimet.

TREGUESIT E MASAVE TË SIGURIMIT

Gjatë vitit 2016 janë *arrestuar në flagrancë* nga policia gjyqësore 106 të pandehur.

Janë *ndaluar me urdhër të Prokurorit* 15 të pandehur.

Janë kërkuar dhe vleftësuar si të ligjshme në gjykatë 116 arrestime dhe ndalime.

Është kërkuar masa e sigurimit arrest në burg për 60 të persona, për 8 të pandehur masa e sigurimit arrest në burg në mungesë, arrest në burg me afat për 2 të pandehur, për 12 të pandehur arrest në shtëpi, për 36 të pandehur detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore. Gjithsej janë kërkuar në gjykatë 116 masa shtrënguese.

Gjykata ka vendosur për 53 të pandehur masën e sigurimit arrest në burg, për 8 të pandehur arrest në burg në mungesë, për 14 të pandehur arrest në shtëpi, për 6 të

pandehur arrest në burg me afat, për 37 të pandehur detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore.

Nga treguesit statistikor konstatojmë se janë mbështetur nga gjykata kërkesat e prokurorit për caktimin e masës shtrënguese.

Masa e sigurimit arrest në burg është kërkuar në ato raste, për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të autorit, shtrirjen e veprës penale në vend. Masa e sigurimit arrest në burg është kërkuar për veprat penale kundër jetës së personit, tek vepra penale e vrasjes, plagosjes së rëndë me dashje, tek vepra penale e dhunës në familje, tek veprat penale kundër pasurisë dhe ekonomisë, siç kanë qenë vjedhja, trafikimi i mjeteve motorike, për krimet në fushën e doganave, si vepra penale e kontrabandës, si dhe tek veprat penale kundër autoritetit të shtetit, si kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik, tek veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, si shpërdorimi i detyrës, tek veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike, si prodhimi dhe shitja e narkotikëve, prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt, kur drejtuesi i mjetit ka qenë recidivist në rastet kur ka qenë i pa pajisur me leje drejtimi apo kur drejtuesi i mjetit ka qenë në gjendje të dehur.

Masa shtrënguese të tjera është kërkuar në disa raste të veprës penale të kontrabandës me mallra të tjera, kur vlera e mallit kontrabandë ka qenë shumë e vogël, në veprat penale të drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt, i pa pajisur me leje drejtimi, kur nuk kanë qenë persona recidivist dhe nisur nga mosha dhe personaliteti i të pandehurit. Një politikë penale e tillë ka ndikuar edhe në parandalimin e përgjithshëm që rezulton nga rënja e numrit të veprës penale të tillë në krahasim me vitin e kaluar.

TREGUESIT E ZGJATJES SË AFATEVE TË HETIMEVE PARAPRAKE

Janë zgjatur afatet deri në 3 muaj për 11 procedime penale me 11 të pandehur, 2 prej tyre kanë qenë të arrestuar. Mbi 3 muaj deri në 6 muaj janë zgjatur afatet për 2 procedime penal me 2 të pandehur. Kjo ka ndodhur për shkak të pritjes së akteve të ekspertimit.

Siç shihet nga treguesit statistikor ka patur shpejtësi gjatë hetimeve paraprake, duke i kushtuar rëndësi zgjidhjes së duhur të procedimeve penale brenda afatit ligjor, duke garantuar dhe respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut, si dhe dhënien e drejtësisë në kohë.

TREGUESIT E MARRËDHËNIEVE JURIDIKSIONALE ME JASHTË

Gjatë vitit 2017 janë paraqitur në Gjykatë 19 kërkesa për ekstradim për Jashtë Shtetit të personave të arrestuar në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të kërkuar nga

Autoritetet e Shteteve të Tjera. Gjykata ka vendosur lejimin e ekstradimit për 15 persona, dy janë në pritje për miratimin e ekstradimit dhe në një rast është refuzuar ekstradimi.

Janë ekzekutuar 52 Letërporosi nga Jashtë Shetit, kryesisht nga Autoritetet e Drejtësisë Kosovare, që kanë patur të bëjnë me njoftimin e dëshmitarëve apo të pandehurit, pyetjen e dëshmitarëve, etj. Janë dërguar për Jashtë shtetit 28 letërporosi për marrjen e provave. Është bërë njohja e vendimeve penale të Gjykatave të Kosovës për 4 të dënuar, shtetas shqiptar, dhe u është kërkuar Autoriteteve të Huaja njohja e vendimit penal të Gjykatës së Rrethit Kukës në 6 raste.

TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

Nga viti 2016 kanë qenë të mbartur vendime të paekzekutuara për 30 të dënuar me burgim, për 110 të dënuar me gjobë dhe 111 të dënuar me kusht.

Gjatë vitit 2018 janë nxjerrë nga Prokuroria urdhërat e ekzekutimit të vendimeve penale për 60 të dënuar me burgim, për 71 të dënuar me gjobë, për 156 të dënuar me kusht dhe për 5 të dënuar duke aplikuar nenin 63 të K.Penal(kryesisht të dënuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 190/1 të Kpenal.).

Gjatë vitit 2017 rezulton të jenë ekzekutuar vendimet penale për 47 të dënuar me burgim, 1 të dënuar me gjobë, për 27 të dënuar me kusht.

Kanë mbetur të paekzekutuara për vitin në vazhdim vendimet penale për 14 të dënuar me burgim dhe 70 të dënuar me gjobë dhe 174 të dënuar me kusht.

ADMINISTRIMI I PROKURORISË

Në mbarëvajtjen e punës së veprimtarisë në Prokurorinë Kukës, një rol të rëndësishëm kryen edhe administrata e prokurorisë. Rezulton së gjatë vitit 2017 është punuar në përmirësimin e punës së mbajtjes së regjistrave dhe raportimeve periodike të statistikave të prokurorisë. Gjithashtu është punuar për vënien në zbatim të sistemit CAMS.

Një nga shqetësimet, që është bërë prezent edhe në Prokurorinë e Përgjithshme është gjendja e Arkivit të Prokurorisë Kukës, i cili ka mbingarkesë, dhe kemi kërkuar ndihmën e Prokurorisë së Përgjithshme për zgjidhjen e këtij problemi.

Në lidhje me administrimin e prokurorisë gjatë vitit 2017 administrimi ka qenë i drejtë për sa i përket zbatimit të buxhetit dhe kapaciteteve infrastrukturore të saj. Fondet e akorduara

nga Prokuroria e Përgjithshme janë menaxhuar në mënyrë efektive dhe realizimi i tyre ka qenë në masën 99.9 %.

Nuk janë evidentuar probleme me sigurinë e brendshme për mbarrimin e punës. Menaxhimi i brendshëm i Prokurorisë ka qenë efikas, ka patur rregullsi në mbajtjen e regjistrave sipas praktikës së normuar të kësaj prokurorie. Gjithashtu ka patur korrektësi në ndjekjen e disiplinës dhe etikës në punë nga punonjësit..

Duke përfunduar këtë raport për ecurinë e punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës prioritetet si dhe sfidat për vitin 2018 janë:

1. Rritja e besimit të publikut tek institucioni i prokurorisë, duke ushtruar në mënyrë efektive ndjekjen penale vecanerisht për veprat penale kundër jetës, veprat penale në fushën e doganave, të korrupsionit, shpërdorimit të detyrës nga zyrtarë të të gjitha niveleve etj.
2. Krijimi i një frymë bashkëpunimi me të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë duke vecuar marrëdhëniet e bashkëpunimit me Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës së bashku me dy komisaritet e policisë të Kukësit dhe Hasit si dhe Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit Kukës si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës;
3. Respektimi i të drejtave themelore të njeriut si dhe respektimi i të drejtave procedurale të të gjithë subjekteve procedurale si viktimës ashtu edhe të pandehurve.
4. Respektimi si dhe marrja e masave të menjehershme për zbatimin sa më rigoroz të ligjit nr.37/2017 “Kodi i drejtësisë penale për të miturit”, ligji i cili ka hyrë në fuqi në datën 1 Janar 2018.
5. Përfundimi në kohë të shpejtë i procedimeve penale të mbartura.

DREJTUESI I PROKURORISË
ALKETA NUSHI